



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

---

Nr. 1106/3 Prot.

Tiranë, më 23/ 12 /2017

**V E N D I M**

**Nr.189, Datë 23/12/2017**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KRUIJË, NË ISH BASHKINË  
FUSHË-KRUIJË DHE ISH KOMUNAT THUMANË, NIKEL, BUBQ E CUDHI  
“MBI PËRPUTHSHMËRINË”  
PËR PERIUdhËN nga data 01.01.2014 DERI 31.12.2016**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Bashkinë Krujë, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Krujë rezultoi që janë konstatuar disa shkelje dhe parregullsi në zbatimin e VKM nr. 510, datë 06.10.2015“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, në mbështetje të neneve 10,15,25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**VENDOSA:**

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për dhënien e një opinioni objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret që mbuloi periudhën nga data 01/01/2014 deri më 31/12/2016”, të ushtruar në Bashkinë Krujë, sipas programit nr. 776/1 prot., datë 24.07.2017, për veprimtarinë nga data 01/01/2014 deri më 31/12/2016.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## **A. KONKLUZIONE /OPINIONE**

Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer në subjektin e **Bashkisë Krujë**, në ish bashkitë **Fushë Krujë** dhe ish 4, komunat **Thumanë, Nikel, Bubq dhe Cudhi**, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), në zbatimin e VKM 510, datë 10.6.2015 për transferimin e të drejtave, detyrimeve, arkivës etj., të ish komunave të përfshira nga riorganizimi administrativo-territorial në Bashkinë Krujë, nuk janë inventarizuar dhe regjistruar në ZRPP dhe në kontabilitet të 119 aktiveve të trupëzuara, prona të Bashkisë Krujë dhe ish Bashkisë Fushë-Krujë dhe ish komunave Thumanë, Nikel, Bubq dhe Cudhi dhe nuk është kryer inventarizimi i pasurisë publike për vitin 2014-2016. Nuk është bërë transferimi i dokumenteve arkivor në Bashkinë Krujë. Mos kryerjen e reformës në organikën e administratës Bashkisë në kohën e parashikuar në VKM nr. 510, dhe vendimit të marrë për shkurtimin e organikës së punonjësve nga Kryetari.

Kryetari i Bashkisë dhe grupi i punës nuk kanë marrë masat e duhura për zbatimin e VKM 510, datë 10.6.2015 për transferimin e të drejtave, detyrimeve.

Devijimet e mësipërme, në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

## **B. MASAT ORGANIZATIVE**

**1.-Gjetje nga auditimi:** Grupi i punës i ngritur me urdhrin e titullarit nr. nr. 81, datë 15.09.2015 të Kryetarit të Bashkisë Krujë, për zbatimin e kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, nuk ka hartuar program pune sipas fushave përkatëse për transferimin e personelit, të drejtave dhe detyrimeve të ish komunave, të arkivave e dokumentacionit tjetër zyrtar, regjistrimin e pasurive etj., duke mos ndarë detyra konkrete për secilin specialist përkatës të grupit, me pasojë mos zbatimin e urdhrit të titullarit dhe kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.6.2015 për transferimin e ish komunave të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial (*Më hollësisht trajtuar në pikën III “Mbi transferimit e të drejtave dhe detyrimeve të NJSH-ve të prekura nga riorganizimin administrativo-territorial”*).

**1.1-Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, pasi të nxjerrë përgjegjësitë të kërkojë nga grupi i punës hartimin e një programi pune të veçantë në zbatim të kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

**Menjëherë**

**2.-Gjetje nga auditimi:** Grupi i punës për zbatimin e kërkesave të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, nuk ka ndjekur zbatimin e procesit të reformës administrativo-territoriale, duke mos bërë asnjë raportim te Kryetari i Bashkisë Krujë për ecurinë e detyrave, zbatimin e tyre dhe problematikën që ka dalë në lidhje me transferimin e ish komunave në Bashkinë Krujë. Mos informim i titullarit dhe mungesa e monitorimit të grupit prej tij, ka sjellë mosnjohjen e situatës dhe mos marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e VKM 510, datë 10.6.2015, në kundërshtim me pikës 3, të Kreut II të këtij vendimi.

**2.1-Rekomandim:** Grupi i punës për zbatimin e kërkesave të VKM nr. 510, të identifikojë detyrat ende të pa zbatuara, për këtë të informojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë. Titullari të monitorojë zbatimin e detyrave të grupit dhe të kërkojë prej tij informacione periodike mujore, tremujore etj., për ecurinë e procesit.

**Menjëherë**

**3.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Kryetari i Bashkisë Krujë nuk ka informuar me shkrim, në fund të çdo muaji Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe problematikën e hasur gjatë procesit të transferimit, në kundërshtim me pikën 4 të Kreut II të këtij vendimi.

**3.1-Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Krujë në fund të çdo muaji, të informojë me shkrim, Ministrin e Brendshme, i cila mbulon Çështjet Vendore, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe problematikën e hasur gjatë procesit të transferimit. Për këtë më parë të informohet me shkrim nga grupi i punës për secilën çështje dhe mbi bazën e konkluzioneve të dala të hartohet raporti për Ministrin.

**Menjëherë**

**4.-Gjetje nga auditimi:** Nga ish Bashkia Fushë-Krujë dhe ish Komunat Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi, nuk është plotësuar dhe depozituar pranë Bashkisë Krujë, inventari i të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Nga 119 aktive të trupëzuara, prona të Bashkisë Krujë dhe të ish komunave, nuk është regjistruar asnjë në ZRPP Krujë, nuk janë inventarizuar e nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare. Bashkia Krujë administron vetëm një listë të pronave me objekte të cilat janë të dëmtuara, të zaptuara dhe troje me ndërtime të paligjshme, të trashëguara nga ish Komunat, referuar procesverbalit datë 14.06.2016. Nuk janë zbatuar parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar për miradministrimin e pronave, pasi jo vetëm që nuk janë dhënë me qira për të siguruar të ardhura për buxhetin e njësisë vendore, por rezulton një sipërfaqe trualli prej 455,213.3 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe objektesh prej 15,528.4 m<sup>2</sup> të zaptuara, për të cilat nuk janë marrë masa nga Bashkia Krujë për lirimin e tyre, apo lidhjen e kontratave të qirasë në rastet e mundshme. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kreu III, ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", VKM 510, datë 10.6.2015 pika III. 4.

**4.1-Rekomandimi:** Bashkia Krujë të marrë masa për regjistrimin në ZRPP të pronave, duke përfshirë edhe ato të ish komunave, inventarizimin e pasqyrimin e tyre në kontabilitet, lirim nga zaptuesit dhe kthimin e tyre në administrim të saj. Të gjejë forma efikase nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare elektronike institucionit, në media etj., për dhënien e tyre me qira me qëllim sigurimin e të ardhurave për njësinë vendore.

**Menjëherë**

**5.-Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2015 dhe 2016 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve në Bashkinë e Krujës, por nuk është kryer inventarizimi konkret i pasurisë publike. Në mungesë të inventarizimit, llogaritë përkatëse të bilancit që lidhen me inventarët, nuk japin besueshmëri se paraqesin drejtë vlerën e aktiveve, hartimi i bilancit të konsoliduar, nuk paraqet gjendjen reale të pasurisë së institucionit të Bashkisë dhe ish komunave. Për këtë arsye grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme për sa i përket vlerësimit dhe kontabilizimit të aktiveve, duke gjykuar se pasuria e institucionit e shprehur në aktivin e bilancit nuk është e saktë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pikën 73, 78, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e asetëve në sektorin publik”.

**5.1-Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Krujë të ngrihet një komision i posaçëm për kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm të pasurisë të luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë edhe Njësitë Administrative. Për mangësish materiale të merren masa për zhdëmtimin e tyre nga personat përgjegjës.

**Menjëherë**

**6.-Gjetje nga auditimi:** Arkivat e ish Bashkisë Fushë-Krujë, ish Komunave Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi, bazuar në VKM 510, datë 10.06.2015, kanë pasur si afat maksimal për transferimin e dokumentacionit deri në fund të muajit janar 2016, por nga auditimi u konstatua se transferimi i dokumentacionit nga arkivat e ish komunës në arkivat e Bashkisë Krujë nuk është kryer ende. Nuk ka një plan të përgatitur nga Bashkia për sigurimin e ambienteve të përshtatshme për këtë qëllim. Ruajtja e dokumentacionit ende në ambientet e ish komunave nuk jep siguri për rrezikun nga humbja, vjedhjet, agjentë atmosferikë etj., pasi nga titullari nuk janë hartuar rregulla të shkruara për këtë qëllim deri në momentin e transferimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 2, kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

**6.1-Rekomandimi:** Bashkia Krujë të marrë masa për transferimin e dokumenteve arkivore të ish Bashkisë Fushë-Krujë dhe ish Komunave Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi në ambientet e saj. Dokumentet arkivore, përpara dorëzimit të jenë të sistemuara dhe të inventarizuara e dorëzimi të bëhet me procesverbal, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat dhe VKM 510. Me transferimin pranë Bashkisë, një kopje e arkivit të ruhet edhe pranë ish komunave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në format shkresor ose të digjitalizuar. Këto dokumente duhet të rrinë qartësisht të ndara nga dokumentacioni tjetër i Bashkisë Krujë.

**Menjëherë**

**7.-Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i moszbatimit në vazhdimësi nga institucioni të procedurave ligjore për largimin e punonjësve nga puna, u konstatua një efekt negativ financiar në buxhet në vlerën 8,676,168 leke, nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të humbura nga institucioni. Efektet financiare të mësipërme, të cilat janë të mundura të eliminohen nga institucioni, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore përpara largimit të punonjësit nga puna, kanë impakt negativ në fondet publike të institucionit. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë analizuar vendimet gjyqësore, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

**7.1-Rekomandim:** Në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, nga institucioni të zbatohen të gjitha procedurat ligjore të largimit, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhet. Nga titullari, përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, të analizohen këto vendime, të nxirren përgjegjësitë administrative, duke përcaktuar shkakun e ndodhjes së tyre, si dhe të nxirret akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

**Menjëherë**

**8.-Gjetje nga auditimi:** Miratimi buxhetit të Bashkisë Krujë për periudhën 2014-2016 është miratuar me vonesa të dukshme, jashtë afateve ligjore të përcaktuar në nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të cilat sjellin kufizime e vonesa në vendimmarrje, për nivelin e shpenzimeve operative dhe investimet, të ardhurave, numrin e punonjësve etj.

**8.1-Rekomandimi:** Bashkisë Krujë të marrë masat e nevojshme që buxheti i njësisë vendore të miratohet brenda afateve ligjore, me qëllim eliminimin e pengesave në zbatim, si për planifikimin e realizimin e të ardhurave dhe për realizimin e shpenzimeve.

**Menjëherë**

**9.-Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë nuk ka zbatuar kronologjinë kohore të zbatimit të vendimeve gjyqësore për largimet nga puna të punonjësve, duke mos hartuar grafikë për shlyerjen e këtyre detyrimeve sipas radhës së daljes së vendimit, me rregull shterues, duke filluar nga vendimet me data më të hershme e në vazhdim. Kjo humbet besimin e qytetarëve të institucioni dhe krijon pabarazi në trajtimin e çështjeve të njëjta dhe veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 5, germa a të UMF nr. 1, datë 04.06.2014.

**9.1-Rekomandimi:** Bashkia Krujë të realizojë *ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti vendor , sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre, duke filluar nga viti paraardhës dhe grafiku i shlyerjes behet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të institucionit.*

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

## **C. MASA DISIPLINORE:**

## **C1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.**

Në Mbështetje të shkronjës c) nenit 15-Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja (b), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronja “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Krujë, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 6 punonjësit e mëposhtëm:

**1.M.D**, me detyrë Drejtorie Personelit dhe Burimeve Njerëzore në cilësinë e Anëtarit të Grupit të Punës të ngritur pranë Bashkisë Krujë për të siguruar zbatimin e transferimit të drejtave dhe detyrimeve të NJSH-ve.

**2.R.B**, me detyrë Përgjegjëse Sektori Personeli, në cilësinë e Anëtarit të Grupit të Punës të ngritur pranë Bashkisë Krujë për të siguruar zbatimin e transferimit të drejtave dhe detyrimeve të NJSH-ve,

**3.A.D**, me detyrë Drejtor i Planifikimit Kontrollit të Zhvidhimit Territorit në cilësinë e Anëtarit të Grupit të Punës të ngritur pranë Bashkisë Krujë për të siguruar zbatimin e transferimit të drejtave dhe detyrimeve të NJSH-ve, për dëmtimin e objekteve të Bashkisë dhe ndërtimet në pronën e saj pa leje.

**4.L.P**, me detyrë Specialiste e Degës Tatim Taksave, në cilësinë e Anëtarit të Grupit të Punës të ngritur pranë Bashkisë Krujë për të siguruar zbatimin e transferimit të drejtave dhe detyrimeve të NJSH-ve,

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk kanë zbatuar plotësisht urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Krujë nr. 81, datë 15.09.2015, për ngritjen e grupit të punës “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

-Për mos zbatimin e procedurave dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, VKM nr. 510, datë 10.6.2015, Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

**5.Znj. E.P**, me detyrë përgjegjëse e Arkivës NJSH-në Thumanë, sot specialiste për mirëmbajtjen e zyrave të administratën e Bashkisë Krujë.

**6.Z. A.S**, me detyrë përgjegjës i Arkivës në ish NJSH- Fushë- Krujë , sot specialist i Tatim Taksave. Bashkia Krujë

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk kanë arkivuar pranë arkivave shtetërore vendore, dokumentacionin përkatës, sipas juridiksionit territorial si dhe pranë Bashkisë Krujë si dhe nuk kanë kryer përpunimin e tyre, në kundërshtim me pikën 2, Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

-Nuk kanë kryer përpunimin apo klasifikimin e dokumentacionit që disponon zyra e arkivit Bashka Krujë, në kundërshtim me normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të miratuara me vendimin nr. 1, datë 16.1.2004, të Këshillit të Lartë të Arkivave, në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat".

**Shënim:** Mendojmë që mos të propozojmë masë disiplinore për 4 punonjësit e mëposhtëm në cilësinë e Antarëve të Grupit të Punë të ngritur pranë Bashkisë Krujë për të siguruar zbatimin e transferimit të drejtave dhe detyrimeve të NJSH-ve, pasi me *Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr. 169, datë 15.12.2017 "Auditimin e Ushtruar në Bashkinë Krujë " Për Auditimin e Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë, për periudhën nga data 01.01.2015 deri me 30.07.2017, ndaj tyre është rekomanduar njëherë masë disiplinore dhe konkretisht :*

- 1.Xh.Xh.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Financës,
- 2.R.S.** me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Financës,
- 3.A.H.** me detyrë Specialiste e Drejtorinë Juridike,
- 4.E.S.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike,

#### **G. TË TJERA:**

Ky auditim vlerësohet shumë dobët nga Kryetari i KLSH-së. Do riauditohet në një kohë të dytë e gjithë kjo periudhë për ish-Bashkinë Fushë Krujë dhe 4 ish Komunat Thumanë, Nikël, Bubq dhe Cudhi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë Vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**